

TRANSLATION/PËRKTHIMI



Luksemburg, 30 qershor 2017

SG/CR/CS/HL/JMSB/hd

I nderuar

I referohemi korrespondencës suaj të datës 26 maj 2017 për Bankën Evropiane të Investimeve (BEI) në lidhje me projektin Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) i cili na është transmetuar nga mekanizmi i ankesave të BEI më 14 qershor 2017. Gjithashtu i referohemi korrespondencës së 16 qershorit 2017 që na është dërguar nga mekanizmi i ankesave të BEI duke ju informuar se ankesa juaj është transferuar në shërbimet operative të Bankës.

Së pari, duam t'ju falënderojmë që morët kohën të tërhiqnit vëmendjen e Bankës për çështjet e ngritura në letrën tuaj. Ju lutem të jeni të sigurt se, si Bankë e BE-së, BEI zbaton standardet më të larta në vlerësimin teknik, ekonomik, financiar, mjedisor dhe social për të gjitha projektet që financon dhe kërkon pajtueshmërinë dhe përputhjen me ligjet kombëtare, si edhe me standardet mjedisore dhe sociale të BEI-së.¹

Brenda këtij konteksti, duam t'ju informojmë se aktualisht BEI nuk po e financon këtë projekt por po e merr në shqyrtim për të vendosur nëse do ta mbështesë ose jo.


Gjithashtu duam të theksojmë se TAP-i, si promotor i projektit, ka përgjegjësinë bazë për implementimin e duhur të programit Përdorimi dhe Blerja e Tokës në përputhje me ligjin vendas dhe, në rast të financimit të BEI-së, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të BEI-së.

Për më tepër, si pjesë e angazhimit të tyre social për komunitetet lokale, TAP-i është përgjegjës për dhënien e përgjigjeve për kërkesat dhe pyetjet e caktuara të ngritura nga njerëzit e prekur prej projektit në lidhje me rastet e tyre individuale. Prandaj ju nxitim të vazhdoni gjithashtu të punoni direkt me promotorin për të marrë qartësime mbi çështjet e ngritura në korrespondencën tuaj dhe t'ia paraqitni shqetësimet tuaja mekanizmit të ankesave mbi projektin detajet e kontaktit të të cilit gjenden në faqen e internetit të dedikuar².

Nëse tashmë keni ngritur shqetësimet tuaja me TAP-in dhe këto nuk janë zgjidhur, ju lutem na njoftoni dhe na tregoni nëse autorizoni BEI-në të zbulojë detajet e rastit tuaj, si për shembull identitetin, për TAP-in.

¹ Për informacione të mëtejshëm në lidhje me standardet mjedisore dhe sociale të zbatuara për projektet që financon BEI, mund të konsultoheni me Volumn I të botimit përkatës: <http://www.eib.org/infocentre/publications/all/environmental-and-social-practices-handbook.htm>

² <http://www.tap-ag.com/grievance>



Shpresojmë që këto informacione të jenë të dobishme për ju dhe jemi në dispozicionin tuaj nëse doni të na jepni informacione të mëtejshme ose nëse ju duhen qartësime të mëtejshme në lidhje me aktivitetet e BEI-së ose me përfshirjen e saj në këtë projekt³.

Me respekt,

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE

Kryetar i Divizionit

Nënkryetar i Divizionit

Divizioni i Shoqërisë Civile
Sekretariati i Përgjithshëm

³ Në përputhje me pikën 5.31 të Politikës së Transparencës së Grupit BEI, ju lutem të jeni në dijeni se, nëse kjo përgjigje ju duket e pakënaqshme, keni të drejtën të bëni një aplikim miratues ose të bëni një ankesë me mekanizmin e ankesave të BEI-së.